Universi poetik i Vera Istrefit

Vera Istrefi: Shiu i fundit

Vera Istrefi

* * *

Shiu i fundit

Ka ardhë pranvera
Do vesh fustanin e zi
do të vij të çoshja e zakonshme
ku dhe pema përballë lëkundet.

Mos ke frikë.

Me të dalë dielli
fustani do të shndrisë
e gjethet e pemës
s'do të dridhen

2
Shiu i fundit
m'i ka lagur flokët

Koka më është rënduar
Mbetem në vend
Koha është duke vrapuar

3
Koha
në rrugën e saj më hedh
me vizionin e vdekjes së afërt
në ecje

4
Mbrëmja
e veshur me mantelin e padukshëm
hesht mbi rrugë
Unë
rënduar nga heshtja
eci
Marr me vete copa betoni
që s'më lënë të qetë
për asnjë çast
Shpirti s'njeh kufij kohore
prej mbrëmjeje
Kufij tokësorë prej betoni
Ndaj

fluturon e s'di ku shkon…

5

Sytë,
vetëm syve ua kam frikën
e s'mund ta fsheh vetveten

6

Mua,virgjëreshës
po më pikojnë gjinjtë
Në mungesë të foshnjes
nuk e di ç'dua

7

Qirinjtë e gëzimit po shuhen
Të urrej,
pse të dua marrëzisht
pse më mbyt tinëzisht
me pabesinë tënde

8

Ritual
Në mëngjes:
një kafe
Në mbrëmje:
një kafe
Kafeja greke
e vetme me bollëk
në qytetin tonë

9

E ruaj puthjen tënde
në anën e majtë të qafës
Ky nishan i zi
më kujton

të bardhën puthje

10

Në të vetmin çast
më erdhën në mendje dy vizione:
i dashurisë dhe i vdekjes

11

Nëse s'të takoj
do të pres në botën tjetër
S'do të trembem nga erë e vdekjes
Nëse s'të takoj as atje
vetëm atëherë
mendo se kam vdekur

12

Shi malli kam në shpirt
Shpirtin e grisur bart
Plagë të padëshirueshme

13

Sot
edhe zogjtë fluturojnë hutueshëm

14

Eci poshtë zogjve
përkrah njerëzve

15

Jam e vdekur në këtë mjedis
ndjej
kur jam e vdekur

16

Paskam bërë mbi letër

njolla të pakuptimta
Njolla-lot mendimesh

17
Do të jepem e tëra
me po atë forcë
me të ciën s'do të të jepesha kurrë

18
Të isha pikëz shiu
të lag pak tokë
vetëm toka të mos më lagë
të shembej diçka nga unë mbi botë

19
Gur varri të të bëhem
lermë të bëhem për ty

20
Sytë e tu lodrojnë mbi gjinjtë e mi
Sytë e mi pështirosin sytë e tu

21
Zvarrë paske tërhequr këmbët
Gjer në sosje të kockës
Thërrimet e kockave
Ende s'i di ku kanë mbetur

23
Të kam borxh
-puthje
-pritje
-ëndërr
-dhimbje
-dashuri

Sa jetë kam unë?
E tëra po të jepem!

24
Të përbuza
jo për të thënat…
Për të pashprehurat

25
Më merr
paimagjinueshëm diçka
Vështirë e kam t'i vë emër
Duke imituar të tjerët
them
më merr malli për ty

26
Ngado më ke ndjekur
shpirtin ma copëtove
hije e mjerimit

27
M'i ke lënë buzët në gjysmëputhje
e mua
Më ke lënë
gjysmëvdekur

28
Nuk pres
Vetëm të lind
Të vuaj
Të vdes

29
për ty s'dua të jem

Lady Makbeth
Megjithatë
e çmendur jam
se dyluftoj me veten
e shpirtin e zbeh

30
E përditshme
Çdo ditë gënjej veten
Me vezullimë
Që shkëlqejnë gënjeshtërt

31
Nën jorganin e qefinjtë
mbarset koha me shpresën e ngrohtë
Do ta festoj pranverën që vjen

32
Cilëve tu jap të drejtë:
Të penduarve-vdekur
Të gjallëve-marrosur…

33
Miza lodron mbi pjatat e palara
Unë
qaj për shpirtrat e pashpirt

34
Në sallonin
e vetvetes time
mbeta thjesht
shërbëtore e huaj

35
Kam ecje të trishtë

Thonë e kam natyrën kështu
Vetë…s'di ç'të them

36
Më parë
s'mendoja për krisma qelqurinash
e buzëqeshje të shtirura
Sot
nuk e di ç'kam
Grindem dhe me veten
Vetëgrindja
i vetmi rrafsh pasqyrimi
për mua

37
Asgjë s'u dëgjua sonte
Veç një përplasje gotash

38
Diçka
të papërsëritshme pati e djeshmja
të paqenë tek e sotmja
Jam në mjegull
Vërtet jam ajo që isha dje
apo linda sot
bashkë me ëdrrën e së djeshmes?!

39
Thonë:
Në fytyrën e të vdekurit
lexon lamtumirën
Këtë gjë
e lexoj
në fytyrën e të gjallëve
si e vetmja gjë që i lidh njerëzit

40

Më ndjekin sytë hirtë
Unë i shmang
Veç me sytë e mendjes
i vërej sytë e hirtë

41

Vrapoj drejt lindjes
Nxitoj drejt vdekjes
Si qenie mitologjike
Mbi shpinën e fatit

42

Lulëmirës
-Vogëlushes së Kosovës që erdhi në
Kukës në ditët e dyndjes tragjike-

Lulëmirë
Nuk t'i shoh sytë
Veç copëzat e tyre
Si copëza kristali
22 maj 1999

43

Pranvera nuk filloi
As nga qielli
As nga toka
2 prill 1999

44

Vetmia
në gjysmëdremitje
Lodron para syve të mi
Poezia

45

Femrat në sy kanë lot
Loti për mua është luks

46

Vitet kalojnë e plaken ngadalë
Mbaron pritja…

47

Çarçafi i zhubrosur
provë fajësie
e paqfajësie njëkohësisht
Këputja jonë
prehet mbi te…

48

Zakon i hershëm
Më tërheqin vëmendjen
për thembrat e këpucëve
Rruga ime…
s'mund të eci ndryshe mbi ty

49

Bëni kujdes me mua
Një fill kam mes dashurisë e urrejtjes

50

Ti flet
Unë shoh të kuqin e buzëve të mia
Përgjatë buzëve të gotës

51

Llaku i rënë nga thonjtë
më trishton

Si ëndrra ime

52

Nën qepallat e mi atë përlotura
të zvarris
e s'ngopem së të ndëshkuari

53

Në mbrëmjen e vallëzimit
vathi më mungon
humbur në përqafim